



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË**  
**BORDI I AKREDITIMIT**

**VENDIM**

**Nr. 134, datë 21.06.2025**

**PËR**

**AKREDITIMIN PERIODIK TË PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË  
MASTER I SHKENCAVE NË “FINANCË DHE KONTABILITET”, ME PROFILE  
“FINANCË DHE BANKË”, “KONTABILITET DHE AUDITIM”, TË KOLEGJIT  
UNIVERSITAR “INSTITUTI KANADEZ I TEKNOLOGJISË”**

Bordi i Akreditimit, bazuar në Ligjin Nr. 80 datë 17.09.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Ligji Nr. 8480, datë 27.5.1999 “Për funksionimin e Organeve Kolegjiale të Administratës Shtetërore dhe Enteve Publike”, Ligjin Nr. 44/2015, datë 30.04.2015, “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”, Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 109, datë 15.02.2017 “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë e të Bordit të Akreditimit dhe për përcaktimin e tarifave për proceset e sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë”, i ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 824, datë 24.12.2021, “Për miratimin e Kodit të Cilësisë së Arsimit të Lartë”, Vendimin e Bordit të Akreditimit Nr. 2, datë 07.04.2017, “Për përcaktimin e kohëzgjatjes dhe afateve të vlefshmërisë së akreditimit në kuadër të vendimmarrjes për akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe Programeve të Studimit” dhe Vendimin e Bordit të Akreditimit Nr. 224, datë 15.12.2023 “Për miratimin e Rregullores së Bordit të Akreditimit”, në mbledhjen e tij të datës 21.06.2025, në kuadër të vendimmarrjes për akreditimin periodik të programit të studimit të ciklit të dytë, Master i Shkencave në **“Financë dhe Kontabilitet”, me profile “Financë dhe Bankë”, “Kontabilitet dhe Auditim”, me të dhënat si më poshtë:**

- a) Emërtimi i programit: Master i Shkencave në **“Financë dhe Kontabilitet”, me profile “Financë dhe Bankë”, “Kontabilitet dhe Auditim”**
- b) Cikli i studimit: Cikli i dytë
- c) Akti zyrtar i hapjes/licensimit: Urdhër i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit Nr.567, datë 02.12.2016
- d) Akreditimi i parë: Vendim i Bordit të Akreditimit Nr. 74 datë 04.10.2019
- e) Institucioni që e ofron: Kolegji Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë”
- f) Njësia bazë përgjegjëse: Departamenti i Administrim Biznesi
- g) Kohëzgjatja (Vite/semestra): 2 vite / 4 semestra
- h) Kredite (ECTS): 120 kredite
- i) Forma e studimit: Me kohë të plotë
- j) Gjuha e mësimdhënies: Anglisht

- k) Statusi i diplomës: ofrohet vetëm nga Kolegji Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë”
- l) Niveli i diplomës në kuadrin e Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve: Niveli 7

**pasi mori në shqyrtim:**

- a. Dokumentacionin e Vetëvlerësimit, përfshirë të dhënat e programit të studimit;
- b. Raportin e Vetëvlerësimit dhe dokumentacionin mbështetës;
- c. Dokumentacionin e Vlerësimit të Jashtëm, përfshirë Raportin e Vlerësimit të Jashtëm, dhe dokumentacionin shtesë;
- d. Vlerësimin e cilësisë në përmbajtje, të kryer nga ekspertët e jashtëm në përbërje të Grupit të Vlerësimit të Jashtëm;
- e. Procedurën e vlerësimit të ndjekur dhe monitoruar nga ASCAL;
- f. Komunikimin e vërejtjet e institucionit në kuadër të këtij procesi;
- g. Shkallën e përmbushjes së rekomandimeve të lëna nga akreditimi i parë;

**konstaton se:**

- a. Procedura dhe procesi i vlerësimit janë kryer në përputhje me parashikimet ligjore dhe nënligjore dhe afatet e përcaktuara në këto akte;
- b. Vlerësimi në përmbajtje është i mbështetur në Dokumentacionin e Vetëvlerësimit, Vlerësimit të Jashtëm dhe gjetjet e verifikimet gjatë vizitës në institucion;
- c. Raporti është hartuar në përputhje me kërkesat dhe i mbështetur me fakte, të dhëna e dokumentacion plotësues;
- d. Rezultatet e vlerësimit janë nxjerrë në përputhje me gjetjet, pikat e forta e afirmimet dhe pikat e dobëta, të identifikuar e verifikuar përmes dokumentacionit dhe vizitës në institucion;
- e. Rezultati i akreditimit të parë të këtij programi ka qënë pozitiv, me rekomandime;
- f. Institucioni ka përmbushur rekomandimet e lëna nga akreditimi i parë;
- g. Rezultati i vlerësimit në lidhje me shkallën e plotësisë të “*Standardeve për sigurimin e cilësisë për programet e studimeve të ciklit të dytë “Master i Shkencave”*” dhe cilësinë e ofertës akademike të programit të studimit, është “**i përmbush kryesisht standardet**”, me mangësi si më poshtë:
  - 1. Institucioni nuk përdor sisteme elektronike për vlerësimin dhe korigjimin e testeve dhe provimeve të studentëve të këtij programi studimi.
  - 2. Mosplotësimi i numrit të kuotave të parashikuara për regjistrimin e studentëve në profilin “Financë dhe Bankë”.

*Mbështetur mbi rezultatet dhe arsyetimin e mësipërm, Bordi i Akreditimit,*

**VENDOSI:**

- 1. Vlerësimin përfundimtar **POZITIV** për programin e studimit Master i Shkencave në “**Financë dhe Kontabilitet**”, me profile “**Financë dhe Bankë**”, “**Kontabilitet dhe Auditim**”, të Kolegjit Universitar “**Instituti Kanadez i Teknologjisë**”.

2. **Akreditimin** e programit të studimit me kohëzgjatjen prej **5 (pesë)** vite.
3. Afati përfundimtar i vlefshmërisë së akreditimit të programit të studimit është **20.06.2030**.
4. Ngarkohet Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë për zbatimin e këtij vendimi, publikimin dhe lëshimin e certifikatës së akreditimit brenda një muaji nga data e marrjes së këtij vendimi, si dhe monitorimin për ruajtjen në vijim të Standardeve të Kodit të Cilësisë dhe plotësimin e rekomandimeve sipas shtojcës bashkëlidhur.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

#### BORDI I AKREDITIMIT

SHQIPONJA TELHAJ		Kryetare
ALEXANDER KOHLER		Anëtar
AYŞEN SAVAŞ SARGIN		Anëtar
TOMASZ JELENSKI		Anëtar
IRAJ HASHI		Anëtar
MAURICE OUDEJANS		Anëtar
LEA YPI		Anëtar
KITA SALLABANDA DIAZ		Anëtar
DARINKA PIQANI		Anëtar

DRITAN NAÇE



Anëtar

INDRIT HOXHA



Anëtar